

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date _____, ne baze te Ligjit Nr.8158, date 7.11.1996 "Per miratimin me ndryshime te dekretit Nr.1631, date 1.11.1996 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve ne shoqeri tregtare", ndryshuar me dekretin Nr.1195, date 14.8.1995 dhe ligjin Nr.8099, date 28.3.1996, Ministri i Privatizimeve vendosi:

1. Te krijoj shoqerine anonime "Superfosfati" Kurbin.

2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete, prodhim superfosfati, prodhim acidi, eksport dhe shitje plehrash kimike, import lendesh te para dhe ndihmese, import plehrash kimike, transport dhe parking.

3. Shoqeria do te kete seline e saj ne qytetin e Kurbinut dhe ajo mund te çele, dege filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratimin e organeve kompetente dhe jashte shtetit.

4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 455.000.000 leke, nga e cila vlere e truallit 45.552.000 leke i ndare ne 455.000 aksione, me vlere nominale 1.000 leke.

5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.

6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :

1. Vjollca Karapici
2. Suzana Kasa
3. Kiço Trebicka

7. Ndertimi organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

**DREJTORE E DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE
DHE PRIVATIZIMIT**

Zeneli

PRANVERA ZENELI

13 02 1997



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 5/4, DATE 3.5.2010

PER
 SHPALLJEN NE LIKUIDIM TE SHOQERISE "SUPERFOSFATI" SH.A.
 KURBIN

Ne mbështetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, te nenit te ligjit nr.8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne ligjin nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetërore ne shoqeri tregtare", te ndryshuar, ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me cilesine e zoteruesit te 100% te aksioneve ne shoqerine "Superfosfati" sh.a. Kurbin

URDHEROJ:

1. Prishjen e shoqerise "superfosfati" sh.a. Kurbin dhe shpalljen e saj ne likuidim.
2. Z.Andre GJINAJ emrohet likuidator i shoqerise, me page mujore 45 000 leke.
3. Anetare te Keshillit mbikqyres te kesj shoqerie emrohen:
 Etleva GEGA
 Nerila SADEDINI
 Valentina MURRASHI
4. Te bartohet dokumentacioni ne perputhje me dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
5. Ngarkohet likuidatori i shoqerise per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
6. Urdheri i Ministrit te Industrise dhe Energjetikes nr.3073, date 19.05.2003 dhe i Ministrit te Ekonomise, nr.3994/1, date 13.06.2003 shfuqizohen.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

DRITAN PRISTI

*Ministria e Ekonomise T. Energjetikes
 Baki Murrashi
 Murrashi*